

Duke iu referuar Raportit Konsultativ të ZRRE-së rreth " Mekanizmit Mbështetës për caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike), ne kuptojmë se ZRRE është aktualisht në procesin e përcaktimit të Tarifës Nxitëse për projektet e energjisë së ripërtëritshme për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve solare shtesë prej 20 MW në Kosovë. Raporti Konsultativ i ZRRE-së sugjeron se qëllimi i kësaj nisme është të sigurojë subvencione/ndihmë për një rritje vullnetare të zotimeve për energjinë e ripërtëritshme, sipas Udhëzimit Administrativ të Qeverisë 05/2017, mbi caqet kombëtare të BRE-ve. Përderisa ne mbështesin fuqimisht zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë dhe vlerësojmë progresin e konsiderueshëm të bërë deri më tani në tërheqjen e investimeve në sektorin e BRE-ve, kjo duhet të bëhet përmes mekanizmave të subvencioneve që ka të ngjarë të jenë të qëndrueshëm në planin afatgjatë.

Ne do të dëshironim t'i rikujtonim ZRRE-së që raporti i implementimit i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (ECS) i vitit 2018 vë në dukje përparimin e bërë në përmbushjen e objektivave të detyrueshme prej 25% deri në vitin 2020 prandaj mbështetja përmes subvencioneve për zhvillimin e kapaciteteve shtesë të BRE-ve, d.m.th. për të përmbushur caqet vullnetare duhet të bazohet në procedurat/mekanizmat konkurrues, të cilat do të lejojnë që të shmanget mbikompensimi i investitorëve. Tashmë ka projekte shembuj në rajon, në Shqipëri dhe Mal të Zi që janë realizuar në bazë të procesit të tenderimit konkurrues me pak ose aspak mbështetje nga shteti.

Ne inkurajojmë ZRRE-në të avancojë promovimin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë përmes procesit të tenderimit konkurrues, sipas Udhëzimeve për Ndhmën Shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë 2014-2020.

Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë